



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 16/2 Prot.

Tiranë, më 29 / 02 / 2024

VENDIM

Nr. 5 , datë 29 / 02 / 2024

MBI

**“MIRATIMIN NË FAZË TË DYTË TË LISTËS PËR PËRFITIMIN E BURSAVE
NGA FONDI I MBËSHETJES STUDENTORE PËR STUDENTËT E CIKLIT TË
PARË TË STUDIMEVE (BACHELOR) PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE”**

Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin nr. 903, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë” (i ndryshuar), në Urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 93/1, dt.03.01.2024, “Për fillimin e procedurës së pranimit të aplikimeve dhe shqyrtimit të dokumentacionit (faza 2), nga ana e fakulteteve të UART, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Arteve”, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga studenti aplikues, procesverbalit nr. 16/1 Prot., datë 29.01.2024 të përgatitur nga Kryetarja e Degës së Fakultetit të Muzikës, pas relatimit dhe shqyrtimit e diskutimit nga Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin për përfitimin e bursës nga fondi i mbështetjes studentore për studentin aplikues renditur në Shtojcën nr. 1 dhe Shtojcën nr. 2¹ bashkëlidhur këtij vendimi që ndjek studimet në ciklin e parë të studimeve Bachelor pranë Fakultetit të Muzikës, në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2023-2024.
2. Ky vendim, së bashku me Shtojcën nr. 2 (në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar) të përcillet pranë Ministrisë së

¹ Shtojca nr. 1 dhe Shtojca nr. 2 kanë përmbajtje të njëjtë, me ndryshimin e vetëm se në shtojcën nr. 1 studentët renditen në formatin emër+atësi+mbiemër, ndërsa në shtojcën nr. 2, ata identifikohen me numër matrikullimi.



Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës të Universitetit të Arteve si dhe Drejtoria Ekonomike.

4. Publikimin e vendimit si dhe *Shtojcës nr. 2* në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

20/02
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. *2/2*

BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Lavdrim SAHITAJ



(Kryetar)

Jeton SHEHU

(Anëtar)

Ergis SEFA


(Anëtar)

Prof. Besnik Bisha



(Anëtar)

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI




(Anëtar)

Lorenc VANGJELI



(Anëtar)

Vladimir LLAKAJ



(Anëtar)



Shtojca nr. 2

FAKULTETI I MUZIKËS

Kriteri 3				
Nr.	Numri i matrikullimit	Fakulteti	Programi i studimit	Viti (1-3)
1	AA212A100041	Muzikë	Klarinetë	3 (tretë)



